



## **Raport Progresiv nga CAO – Shqipëri/Kurum Hydro-01/Bradashesh**

*Ky raport paraqet një informacion të përditësuar për procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të drejtuar nga CAO në lidhje me investimin e IFC-së në projektin Kurum Hydro në Shqipëri*

### **PËRMBLEDHJE**

Sipas IFC-së, IFC-ja është financues i një projekti aktiv të Kurum International (“kompania”) në Shqipëri. I kontrolluar nga familja turke Kurum, Grupi Kurum operon në industrinë e hekurit dhe çelikut me vizionin për ta zgjeruar aktivitetin e tij dhe në biznese të tjera që lidhen me këtë industri në Turqi dhe në Ballkan. Kompania e prodhimit të çelikut ka fituar tenderin për 4 hidrocentrale – Ulëz, Shkopet, Bistrica I dhe Bistrica II, që ishin privatizuar nga qeveria shqiptare në vitin 2012.

Projekti do të shërbejë për të financuar (i) blerjen e hidrocentraleve; dhe (ii) investimin në shumën e vlerësuar prej 10 milion Euro për rehabilitimin e këtyre hidrocentraleve. Grupi synon të shfrytëzojë hidrocentralet për të siguruar energji të rinovueshme të pandërprerë për uzinën ekzistuese të çelikut. Përmes këtij projekti, Kurum parashikon reduktimin e kostove të tij për blerjen e energjisë elektrike, dhe sigurimin e burimit të vazhdueshëm të energjisë elektrike për të vazhduar aktivitetin pa ndërprerje të mëdha. Projekti është klasifikuar në Kategorinë Mjedisore B.

Në qershor 2015, në Zyrën e CAO-s u paraqit një ankesë nga disa banorë të cilët jetojnë në afërsi të Uzinës së Çelikut Kurum në Elbasan, Shqipëri. Ankuesit ngrenë shqetësime në lidhje me ndotjen e ajrit dhe të tokës të shkaktuar nga aktiviteti i uzinës, dhe ndikimin që mund të ketë kjo në shëndetin e banorëve. Meqë energjia e prodhuar nga hidrocentral do të përdorej potencialisht për uzinën e çelikut, në korrik 2015 ankesa u vlerësua se i plotësonte kriteret e pranueshmërisë për vlerësim të mëtejshëm dhe në shtator 2015 u ndërmor një mision vlerësues.

### **PROCESI I VLERËSIMIT DHE I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE I DREJTUAR NGA CAO**

#### **Parapërgatitjet për dialog (fondi i vitit 2015)**

Në vijim të misionit vlerësues të ankesës nga CAO, të dyja palët shprehën vullnetin për t’u përfshirë bashkërisht në një proces dialogu të drejtuar nga CAO. Si hap fillestar, CAO komunikoi me palët për të përcaktuar strukturën e procesit, dhe më pas organizoi një workshop për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të komunitetit në fushën e komunikimit efektiv, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe fazave të saj, negocimin e bazuar në interesa, si dhe organizoi një sesion informues për përfaqësuesit e kompanisë mbi parimet e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Gjatë takimit të parë të mbajtur në dhjetor 2015, palët firmosën një Marrëveshje Kuadër për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, e cila përcakton rregullat bazë që do të drejtonin procesin e zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve. Ata gjithashtu ranë dakord për axhendën e ndërmjetësimit, e cila përfshinte çështje të cilësisë së ajrit, zhurmave dhe çështje sociale.

### **Pezullimi i procesit të dialogut për shkak të procesit gjyqësor të riorganizimit (fillimi i vitit 2016 – mesi i vitit 2017)**

Në shkurt 2016, palët ranë dakord ta pezullonin procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përderisa kompania kishte ndërprerë punimet. Periudha e pezullimit u zgjat nga palët deri në korrik 2017 për shkak të procesit gjyqësor të riorganizimit në të cilin ishte kompania. Gjatë kësaj periudhe grupi i CAO-s bëri disa takime bilaterale me palët për të diskutuar rreth statusit të operacioneve të kompanisë dhe për opsionin e preferuar nga palët për vazhdimësinë e procesit.

### **Rifillimi i dialogut dhe organizimi i një vizite të përbashkët në uzinë (gjysma e dytë e vitit 2017)**

Në takimin e përbashkët të mbajtur në korrik 2017, palët ranë dakord që anëtarët e komunitetit të bënin një vizitë në mjediset ku operon kompania, e cila u organizua në shtator 2017. Anëtarët e komunitetit vlerësuan mundësinë për të vizituar uzinën e çelikut, gjë që i ndihmoi të kuptonin më mirë mënyrën si operon kompania dhe rrjedhimisht impaktet e saj mjedisore. Nëse do të citonim një anëtar komuniteti, ai u shpreh *“ajo që sheh nga jashtë është ndryshe nga pamja e brendshme”*.

Ndërkohë që anëtarët e komunitetit vlerësuan se janë bërë disa përmirësime që prej kohës kur ata e kishin vizituar uzinën individualisht (veçanërisht në lidhje me perceptimin e tyre për efektivitetin e filtrave të kapjes së pluhurit), ata mendojnë se ka vend për përmirësime të mëtejshme, dhe u shprehën se janë ende të shqetësuar për ndotjen e ajrit.

Anëtarët e komunitetit u shprehën se e kuptojnë që zhvillimi është i nevojshëm, por se industria nuk duhet t'i dëmtojë njerëzit.

Përfaqësuesit e kompanisë e vlerësuan gjithashtu mundësinë për t'u shpjeguar anëtarëve të komunitetit, që treguan interes mënyrën sesi funksionon kompania, për të kuptuar më mirë strukturën dhe procedurat e operimit të uzinës. Gjithashtu, përfaqësuesit e kompanisë informuan anëtarët e komunitetit se mund të shkojnë e ta vizitojnë uzinën në çdo kohë, madje dhe pa njoftuar paraprakisht. Përfaqësuesit e komunitetit dhe të kompanisë ranë dakord për të organizuar një takim të përbashkët në tetor 2017 për të diskutuar për hapat e mëtejshëm.



## Rezultate të takimit të fundit të përbashkët (Tetor 2017)

Gjatë takimit të fundit të përbashkët të mbajtur në tetor 2017, palët u fokusuan në rishikimin e axhendës së ndërmjetësimit, diskutimin e çështjeve të cilësisë së ajrit dhe eksplorimin e opsioneve për të përmirësuar situatën. Anëtarët e komunitetit theksuan se çështjet që lidhen me cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmave ishin parësore për ta dhe u ra dakord që çështjet sociale të hiqen nga lista e ndërmjetësimit. Çështjet e cilësisë së ajrit përfshijnë: shqetësime që lidhen me shëndetin e anëtarëve të komunitetit; shqetësimet që lidhen me cilësinë e ajrit dhe ndotjen e tokës dhe të ujit. Çështjet e zhurmës lidhen me shqetësime për shëndetin e anëtarëve të komunitetit dhe shqetësimin nga ndotja akustike.

Si rezultat i diskutimeve, palët ranë dakord si më poshtë:

a. Kompania do të:

- i. riparojë çatinë e uzinës së çelikut në zonën e harkut elektrik para muajit dhjetor 2017. Sipas kompanisë kjo do të sigurojë izolim të plotë, (tymi do të mbliidhet plotësisht nga filtrat e kapjes së gazit) dhe rrjedhimisht do ta përmirësojë cilësinë e ajrit rreth kompanisë; si dhe të ulë nivelin e zhurmave;
- ii. ndërtojë një hekurudhë të brendshme për të transportuar skrapin brenda kompanisë. Sipas kompanisë ajo do të vihet në punë në tetor 2017 dhe do të përmirësojë cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmave dhe shmangie të përdorimit të kamionëve;
- iii. sigurojë akses anëtarëve të komunitetit për t'iu bashkuar procesit të pavarur monitorues të Kurum-it; dhe
- iv. përgatitet të diskutojnë me komunitetin në tremujorin e parë të vitit 2018 në lidhje me investimet strategjike afatmesme dhe afatgjata në teknologji për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

b. Anëtarët e komunitetit do të:

- i. caktojnë përfaqësuesit e tyre që do t'i bashkohen procesit monitorues të cilësisë së ajrit; dhe
- ii. monitorojnë zbatimin e përmirësimeve të përmbledhura në paragrafët e mësipërm përmes një vizite të dytë në terren në fund të muajit janar ose fillim të muajit shkurt 2018 dhe do të vazhdojnë të vëzhgojnë impaktin e investimeve të kompanisë në cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmave.

CAO do të komunikojë me palët për të lehtësuar proceset e përbashkëta monitoruese. Ndërkohë që anëtarët e komunitetit vlerësojnë se investimet për të cilat kompania është angazhuar t'i ndërmarrë ka gjasa të përmirësojnë cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmave, ata do të donin të prisnin deri sa të vlerësojnë impaktin e këtyre investimeve për të përcaktuar nëse shqetësimet e tyre janë adresuar apo jo.

Palët ranë dakord për t'u takuar në fillim të muajit shkurt 2018 për të diskutuar për impaktin e investimeve të kompanisë dhe hapat e mëtejshëm.

Publikimi i këtij raporti në faqen e web-it të CAO-s u bë pas miratimit nga të dyja palët.

Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve po vijon, dhe për më shumë informacion për rastin, ndiqni linkun: - [http://www.cao-ombudsman.org/cases/case\\_detail.aspx?id=237](http://www.cao-ombudsman.org/cases/case_detail.aspx?id=237) <http://www.cao-ombudsman.org/cases/...> dhe dokumentet [pwrkatwse nw](http://www.cao-ombudsman.org/cases/document-links/links-237.aspx) <http://www.cao-ombudsman.org/cases/document-links/links-237.aspx> <http://www.cao-ombudsman.org/cases/...>